



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 199/ 2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 rreth orës 15:00,16:00 dhe 18:10 në fshatin Doganaj të Kaçanikut në shkollën “Ali Asllani” në QV 0707D truproja e Xhabir Zharkut ka qëndruar në QV pa bexh identifikues si në periudhën e lartcekur. Sipas parashtruesit të ankesës kjo përbënë shkelje të Rregullës Zgjedhore 13/2009 dhe nenit 177 të Kodit Penal të Kosovës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi një CD.

PZAP-i kërkoi një deklaratë me shkrim nga dëshmitari Drilon Pireva i cili ishte në cilësinë e vëzhguesit nga subjekti politik LVV në të cilën thekson se rreth orës 15 dhe 16:00 në shkollën Ali Asllani në QV 0707D ka qëndruar pa bexh identifikues truproja e Xhabir Zharkut, dhe se gjatë kohës kur kamë incizuar më ka thënë “mos u sillë këndeje se s’ka valë, telefoni nëse te hup ti nuk mundet me të gjet askush”.

Me datën 19.06.2012, PZAP-i kërkoi nga Policia e Kosovës që të ndërmarr masa hetimore për rastin në fjalë.

Në raportin e policisë të datës 19.06.2012 theksohet se në fshatin Doganaj të Kaçanikut në QV 0707D, gjatë gjithë kohës sa kanë qëndruar në këtë QV nuk ka pasur asnjë ankesë apo problem dhe për këtë kanë kontaktuar disa herë gjatë ditës me menaxherin e kësaj Qendre të Votimit Zeqir Xhokli ku çdo gjë ka qenë në rregull.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

### **Ankesa është e pabazuar.**

PZAP-i gjeti nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të asaj natyre për ti vërtetuar pretendimet ankimore, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë të datës 19.06.2012, në të cilën theksohet se gjatë kohës sa kanë qëndruar pjesëtarët e policisë së Kosovës në vendin QV0707D nuk është raportuar dhe nuk ka pasur ndonjë problem apo ndonjë parregullsi.

Ndërsa nga CD-ja e ofruar si provë nga pala ankuese e cila gjendet ne shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë parregullsi e poashtu nga CD-ja nuk mund të vërtetohet se cili është identiteti i personit në fjalë për të cilin pretendohet në ankesë, andaj PZAP-i vlerëson se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa bazuar në fakte, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 199/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i panelit  
Ymer Hoxha**

